



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.66/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Skender Çoçaj kryesues, Arsim Hamzaj dhe Kymete Kicaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Koalicionit AAK-Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, NISMA-Nisma-Socialdemokrate, Konservatorët, Intelektualët, me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 20.01.2025, merr këtë:

V E N D I M

I. **PRANOHET** e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, Anr.66/2025 e datës 18.01.2025.

II. Koalicionit AAK-Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, NISMA-Nisma Socialdemokrate, Konservatorët, Intelektualët, me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 3,500.00 (katërmijë) euro.

III. Detyrohet Koalicioni AAK-Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, NISMA-Nisma Socialdemokrate, Konservatorët, Intelektualët, me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datë 18.01.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me të cilën pretendon se më 18 janar 2025, është identifikuar poster i kandidatit për deputet Nuredin Lushtaku, nga radhët e Koalicionit AAK-Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, NISMA-Nisma Socialdemokrate, Konservatorët, Intelektualët, i vendosur në hapësirë publike, afër Shkollës Filllore "Shaban Jashari", e cila gjendet në rrugën "Faik Jashari" në Skenderaj.

Sipas parashtruesit të ankesës me këtë veprim, është bërë shkelje e nenit 34, paragrafi 2 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës - LZP, si dhe nenit 7 të Rregullores Zgjedhore Nr. 07/2024 Për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur një CD me fotografi, që dëshmon vendosjen e posterit në kundërshtim me nenin 34, paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i LZP-së parasheh: "1.2. *“vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose e sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare, ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronarëve ose shfrytëzuesve.”*

Më tej në ankesë thuhet se përmes këtij veprimi, subjekti përkatës, ka cenuar rëndë dispozitat përkatëse ligjore dhe kërkojnë që masa e sanksionit për shkeljen në fjalë të vendoset në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Më datë 19.01.2025, PZAP-i, e njoftoi Koalicionit AAK-Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, NISMA-Nisma Socialdemokrate, Konservatorët, Intelektualët, për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje deri me 20.01.2025 në ora 09:00.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur me datë 20.01.2025, theksuar se duke u bazuar në fotografinë e paraqitur si provë nga subjekti politik LVV, konstatohet se posterit në fjalë është vendosur në një hapësirë reklamuese, e cila ka qenë e instaluar dhe funksionale edhe para nisjes së fushatës zgjedhore.

Më tej në përgjigje thuhet se kjo hapësirë shfrytëzohet rregullisht për qëllime reklamimi dhe nuk përbën shkelje të dispozitave ligjore të cituara, për më tepër kandidati për deputet Nuredin Lushtaku, ka lidhur kontratë për shfrytëzimin e kësaj hapësire reklamuese, dhe si provë në përgjigje ka bashkangjitur Kontratën e lidhur për shfrytëzimin e hapësirës reklamuese.

Në përgjigjen në ankesë theksohet se nga fotografia e paraqitur si provë në ankesën e Subjektit Politik LVV, vërtetohet se posterit ndodhet jashtë institucionit publik-shkollës, respektivisht gjendet në rrugën kryesore, Rr. "Faik Jashari", dhe kërkojnë nga PZAP i që ankesën e parashtruar nga Subjekti Politik LVV, ta hedhë poshtë ose ta refuzoj si të pabazuar.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Paneli, nga fotografitë e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, të cilat gjenden në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë ka konstatuar se posterit i kandidatit Nuredin Lushtaku, nga radhët e Koalicionit AAK-Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, NISMA-Nisma Socialdemokrate, Konservatorët, Intelektualët, është vendosur në hapësirat publike, konkretisht në rrugën "Faik Jashari" afër Shkollës Filllore "Shaban Jashari", dhe më tej njëjtin veprim Koalicioni AAK-Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, NISMA-Nisma Socialdemokrate, Konservatorët, Intelektualët, ka bërë shkelje të nenit 34, paragrafi 1 të

Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës LZP, konkretisht neni 34, paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i LZP-së parasheh: "1. Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: 1.2 vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose e sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare, ose brenda ose në hapësirat private pa leje e pronarëve ose shfrytëzuesve.

Paneli ka vlerësuar kontratën e bashkangjitur nga Koalicioni AAK-Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, NISMA-Nisma Socialdemokrate, Konservatorët, Intelektualët, e lidhur me datë 07.01.2025, në mes të palëve si qiradhënës N.SH "Foto Kabashi", me seli në Skenderaj, dhe qiramarrësi Nuredin Lushtaku me vendbanim në Prekaz, mirëpo të njëjtën nuk ka mundur ta merr për bazë me rastin e vendosjes për këtë çështje, kjo pasi që Kontrata nuk përmban numër të protokollit dhe datë kur është protokolluar, dhe gjithashtu nuk mund të vërtetohet fakti se qiradhënësi N.SH "Foto Kabashi" ka të drejtë të shfrytëzoj këto hapësira publike për dhënie në shfrytëzim dhe reklamim të materialit zgjedhor, ngase nuk i ka bashkangjitur asnjë provë përgjigjes në ankesë, me të cilën do të vërtetohet fakti se të njëjtat hapësira i ka marrë në shfrytëzim nga Komuna e Skenderajt, përkatësisht ka leje për ta bërë një gjë të tillë.

Neni 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së thekson se në rast se PZAP përcakton se ka ndodhur shkelje e të këtij ligji ose e rregullave të KQZ-së, mundet të vendosë një gjobë ndaj një subjekti politik, në vlerë deri në pesëdhjetëmijë (50,000.00) Euro.

Përveç kësaj një veprim i tillë sanksionohet edhe me nenin 24 paragrafi 6 nën paragrafi 6.1 Rregullës Nr.01/2024, ku përcaktohet se "subjekti politik që është përfitues i fondeve për financimin e subjekteve politike përmes Buxhetit të Republikës së Kosovës dënohet me gjobë deri në njëzetmijë (20, 000.00)euro.

Paneli, me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, se veprimi që përben përsëritje të shkeljes për nga natyra është i njëjtë apo ngjashëm, subjektit politik që ka bërë shkelje të legjislacionit zgjedhor, apo ka bërë shkelje të legjislacionit edhe në proceset e mëparshme zgjedhore, që konsiston në faktin se Koalicionit AAK-Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, NISMA-Nisma Socialdemokrate, Konservatorët, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës.

Përveç të cekurave më lartë Paneli, me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e Koalicionit AAK-Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, NISMA-Nisma Socialdemokrate, Konservatorët, në kuadër të pretendimeve të theksuara në përgjigje në ankesë, mirëpo të njëjtët ishin të pabazuara, të pa qëndrueshme dhe pa bazë ligjore si në dispozitat e Ligjit për Zgjedhje, dhe si të tilla nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka Paneli, vlerësoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, nenit 118 paragrafi 1, neni 120 paragraf 1 nën paragrafi 1.3, të LZP-së, nenit 10 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Rregullores Nr.01/2024 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.66/2025 më datën 20.01.2025

**Kryesues i Panelit,
Skender Coçaj**



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së.